




## **BASHKIA HIMARE**

### **RELACION**

**Objekti: "Restaurimi pjesor i rruges hyrese Manastir (me kalldreme) Piqeras"**



#### **Pershkrim i Projektit:**

Projekti qe parashikohet te realizohet eshte i lidhur me nje segment rruge ne fshatin Piqeras. Ky segment ndodhet ne krahun e majte te rruges Himare Sarande, ne qender te fshatit Piqeras dhe eshte nje rrugice hyrese per ne lagjen drejt Manastirit te ketij fshati. Rruga eshte e shtruar me kalldrem te cregullte, aktualisht i prishur dhe i degraduar, me betone siperfaqesore ne segmente te vecanta, me bare te mbire te eger ne shume segmente te Rruges se Manastirit, sic quhet ky segment rruge;

Segmenti i rruges eshte i mbeshtetur ne nje murr anesor mbajtes i cili ka filluar te degradohet duke u shembur pjese pjese, sic duket nga fotot eshte i rezuar ne vende kyce cka behet e rezikshem cdo perspective te tij, per banoret e lagjes dhe kalimtare;



Gjendja e ketij segmenti rrugeje eshte e tille sa ai nuk kryen funksionin e saj kryesor sepse kalimi i banoreve kryesisht te moshes se trete qe aktualisht banojne aty ne kushtet totale te kesaj rruge dhe perben nje rrezik actual dominant, prandaj ka dale ne menyre emergjente restaurimi i ketij segmenti rruge dhe kthimi i tij ne identitet, me kalldrem te plote tradicional te ketij fshati.

#### **Pershkrim gjendjes ekzistuese:**



Ne kete segment rruge, sic duket nga fotot e mesiperme, ka degradime te ndryshme te kalldremit ne rruge, gerryerje e plote e segmenteve te rruges e dalja e dherave ne siperfaqe; ka shndrim te kalldremeve ne butobetone, te cilat kane zene nje pjese shume te medhe te siperfaqes se rruges qe parashikohet te restaurohet; ka kalime te dukshme ne siperfaqe te rruges te tubacioneve te ujit te pishem dhe te ujrave te bardha; ka barishte te shumta te egra te cilat kane ne vend te kalldremit kane sjelle rezik reshqitje per kalimtare e kesaj rruge; ka nderhyrje nga banoret per banesat e tyre ne drejtim te rruges kryesore me shtresa betoni, te cilat kane ngushtuar gjeresine e rruges dhe kane ndryshuar bazen e ketij segmenti rruge qe eshte kalldremi tradicional i shume rrugicave te fshatrave te bregdetit;



**Vendndodhja:** Bashkia Himare, Njësia administrative Lukove, Fshati Piqeras.  
**Cordinatat** N 40°0'59" E 19°53'22"

**Te dhena te pergjithshme:**



**Pershkrim fizik gjendjes ekzistuese te zones se projektit:**



**Relacion Objekti: "Restaurimi pjesor i rruges hyrese Manastir (me kalldreme) Piqeras"**

### **Pershkrim te projektit qe parashikohet te realizohet:**

Eshte parashikuar te kryhen punime germimi e prishje dhe konkretisht do te behet germimi e transport dheu me Karoce dore 20 m, germimi e mbetjeve te shumta anes kalldreve, grumbullimi dhe transporti i tyre jashte rruges ekzistuese; heqje dherash dhe transport me karro dore, germimi te tyre, grumbullimi dhe jashte rruges ekzistuese; pastrimin nga bimësia e ulët dhe injektimi i solucionit per tharjen e bimeve te keqija qe jane te pranishme gati gati ne tere siperfaqen e kalldremit; pastrimin nga bimësia e ulët muri ne lartesi qe eshet prezente ne te gjithe siperfaqen e murit mbajtes te rruges se kalldreve; prishjet e murit te gurit, ndertimi i te cilave eshte bere jashte sistemit, vende vende per te bllokuar rrugen e per te sherbyer si mure mbajtes te mbeturinave te formuara neper banesat e lagjes; prishje te shtresave prej betony, pergjate kalldremit ekzistues te rruges, te cilat kane zene pjesen me te madhe te rruges se paarshikuar per restaurim; disa prishje muresh prej betony, pergjate dhe anash kalldremit ekzistues te rruges; skarifikim te barishteve brenda rruges se kalldreve dhe shkulje rrenjeve bimeve te vogla te mbira gjate viteve Brenda rruges dhe ne muret mbajtese te ketij segmenti rruge.



Ne vazhdim eshte parashikuar te kryhen punime murature e kalldremit, fillimishte punime murr guri ne lartesi deri 3 m, me llac cemento M.25, qe nenkupton riparimin e murit ekzistues i prishur e gati per te rene, fasada me rrugen kryesore, qe eshte edhe murri mbajtes i ketij segmenti rruge; realizimi i shtreses se reres per kalldremin e ri dhe riparimin e atij ekzistues; ndertim murr guri në lartësi deri 3m me llac gëlqere 1:3 qe lidhet me murrin mbajtes e te fasades se rruges; fugatim muri pastrim mekanik, larje me ujë dhe fugatim; gdhendje guri me korniza; shtresë me pllaka guri; bordurë guri 25\*12; ndërtim shkallë guri; shtresë betoni C 12/15; Panele dërrase për skelë; restaurim kalldrëmi 15-20 cm gati gati ne total te siperfaqes se tij; shtresë kalldrëmi 15-20 cm mbi shtresë rërë; transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5 km;

### **Projektues**

**Ing.Leonard Hysi**